


01-1281



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-95681/24 dt. 23.07.2024, të kërkuarit A.S.”Alberti” me seli në Prishtinë, në rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, pn., me certifikate të biznesit ARBK 810684911, dhe me përfaqësues Skender Bajrami nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën afariste-banesore, të ndërtuara në kuadër, të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, në rr. “Oslo”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 09.09.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** kërkuarit A.S.”Alberti” me seli në Prishtinë, në rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, pn., me certifikate të biznesit ARBK 810684911, dhe me përfaqësues Skender Bajrami nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-95681/24 dt. 23.07.2024, përdorimi i ndërtesës afariste-banesore, me etazhitet B+P+2, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-222829/21 dt. 06.12.2021, në parcelen kadastrale nr. 1745-2, ZK Çagllavicë, në kuadër, të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë.
- II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Oslo” ku ka dalje hyrja me numrat: 13, në Prishtinë, dhe të njejtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesa dhe njësisve të saja në evidencat e regjistrit kadastral.
- VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuar/ pronari A.S.”Alberti” me seli në Prishtinë, në rr. Magjistrale Prishtinë-Ferizaj, pn., me certifikate të biznesit ARBK 810684911, dhe me përfaqësues Skender Bajrami nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-95681/24 dt. 23.07.2024, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit ndërtesën afariste-banesore me etazhitet B+P+2, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 1745-2, ZK Çagllavicë, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-222829/21 dt. 06.12.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-85721/24 dt. 19.07.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuarit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës

së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Emin Bugiqi; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Arsim Rapuca/Orik Imeri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Lirie Beka; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Berat Hasanaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Hekuran Demiri me nr. të licensës 151;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, instalimet e makinerisë, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa afariste-banesore mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa afariste-banesore mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën afariste-banesore.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-95681/24 DT. 09.09.2024

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu